

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Injection-201 CE

RRËSHIRË ELASTIKE PUR E INJEKTUESHME PËR HIDROIZOLIM TË PËRHERSHËM



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Injection-201 CE është rrëshirë poliuretani për injektim me viskozitet të ulët, elastike dhe pa tretës. Në kontakt me ujin, formon një strukturë të njëtrajtshme dhe të mbyllur të papërshkueshme nga uji, e cila është elastike dhe fleksibël.

PËRDORIMET

- Sika® Injection-201 CE duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.
- Sika® Injection-201 CE përdoret për hidroizolim të përhershëm me pak fleksibilitet për të absorbuar lëvizje të kufizuara, të plasaritjeve të thata, të lagështa ose me ujë dhe fugave në beton, tulla dhe gur natyror
 - Sika® Injection-201 CE mund të përdoret për injektimin e SikaFuko®-System (nuk mund të injektohet sërish!)
 - Për përdorim mbi plasaritje me përmbajtje uji nën presion hidrostatik, duhet bërë injektim paraprak me Sika® Injection-101 RC

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përherë elastik, mund të përthithë lëvizje elastike
- Pa tkurrje në kushtet vijuese të thata
- Për shkak të viskozitetit të ulët mund të depërtojë në plasaritje me gjerësi >0.2 mm
- Sika® Injection-201 CE i tharë është inert dhe me rezistencë kimike
- Pa tretës
- Në temperatura të ftohta (< +10°C) Sika® Injection-201 CE mund të përshpejtohet me Sika® Injection-AC20
- Mund të injektohet si një sistem me një përbërës

MIRATIME / STANDARDE

- Certifikata gjermane KTW për ujin e pijshëm
- Produkt injektimi tek betoni për mbushje të plasaritjeve, hapësirave dhe ndërprerjeve (D) sipas EN 1504-5:2004, Deklaratë Performance 35859175, certifikuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë 0761 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë poliuretani me 2 përbërës që reagon në kontakt me ujin, pa tretës	
Ambalazhi	Përbërësi A	10 kg, 20 kg
	Përbërësi B	10.6 kg, 21.2 kg
Ngjyra	Përbërësi A	pa ngjyrë
	Përbërësi B	kafe
Jetëgjatësia	36 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të pahapur.	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në vend të thatë në temperatura midis +5 °C dhe +35 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe lagështia.	

Dendësia	Përbërësi A	Përbërësi B	(ISO 2811)
	~1.00 kg/l	~1.07 kg/l	
Të gjitha vlerat e dendësisë të përcaktuara në +20 °C			
Viskoziteti	~100 mPa·s (miksi, +20 °C)		(ISO 3219)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~43 (7 ditë)	(EN 868)
Moduli i elasticitetit në përkulje	~2 MPa	(ISO 527-1)
Zgjatimi deri në thyerje	~35 %	(ISO 527)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes

Përbërësi A:Përbërësi B 1:1 pjesë për vëllim
Tabela e kohës së reaksionit Sika® Injection-201 CE
 (ISO 9514)

Doza*	Temperatura e materialit		
	+5 °C	+10 °C	+20 °C
0.0 %	~180 min	~180 min	~135 min
0.5 %	~60 min	~55 min	~38 min
1.0 %	~29 min	~32 min	~24 min
2.0 %	~16 min	~17 min	~13 min
3.0 %	~13 min	~14 min	~10 min
5.0 %	~9 min	~7 min	~5 min

*Doza e Sika® Injection-AC20 në % të peshës së Sika® Injection-201 Përb. A

Vlerat e dhëna janë parametra laboratorit dhe mund të ndryshojnë në varësi të objektit dhe kushteve në kantier.

Temperatura e mjedisit +5°C min. / +35°C max.

Temperatura e nënshtresës +5°C min. / +35°C max.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqet me zgavra dhe plasaritje duhet të jenë të pastra, pa grimca të lira, pluhur, vaj dhe çdo substancë që nuk lejon ndërkapjen. Çdo papastërti duhet të fryhet me ajër të kompresuar.

PËRZIERJA

Hidhni përbërësit A & B brenda një ene dhe përzieni ngadalë për të paktën 3 min (max. 250 rpm) derisa të homogjenizohet, duke zbatuar rregullat e sigurisë. Konteinerët furnizohen sipas raportit të kërkuar të përzierjes prej 1 : 1 pjesë për vëllim. Sasitë e përbërësve mund të maten në enë të veçanta. Pas përzierjes, hidhni materialin tek ena e furnizimit të pompës, përzieni për pak dhe përdoreni brenda kohës së punueshmërisë. Nëse temperaturat e nënshtresës dhe/ose ambientit janë < +10°C, mund të shtohet Sika® Injection-AC20 për të përshpejtuar kohën e reaksionit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit sipas skedës teknike për pastrimin e sistemit Sika® Injection.

KUFIZIME

Për përdorim vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe me përvojë. Për depërtime uji që nuk mund të ndalohen me Sika® Injection-201 CE, mund të injektohet rrëshira PUR që shkumëzohet shpejtë Sika® Injection-101 RC derisa të ndalojë rrjedhja e ujit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Injection-201 CE

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020707010020000001

SikaInjection-201CE-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

